



We've got Albanian media covered

Review from Mar, 11. Aug 2009

Keyword: "Krizë ekonomike"



Monitor your interest with the right tools

Contents

	Page
<i>Ekonomi - Economy</i>	
BSH: "Bizneset hasin probleme, rritet kredia për likuiditet"	1
Ballkan, 08/11/2009	
<i>Bizneset po mbijetojnë në treg duke marrë kredipër të paguarpunëtorët apo për të blerë lëndën e parë. Kjo pasi sipërmarrja private po përballlet ...</i>	
Kriza, frenohen të ardhurat doganore	2
Koha Jonë, 08/11/2009	
<i>Plani i gjashtëmujorit, realizohet në masën 88 për qind ...</i>	
INSTAT: Karburantet, në korrik më të shtrenjta	3
Metropol, 08/11/2009	
<i>... Qytetarët kanë blerë karburante me çmime më të larta gjatë' muajit korrik. Instituti i Statistikave bëri të ditur dje indeksin e çmimeve të konsumit, i ...</i>	
Biznesi në krizë, 37% e kredive për të paguar pagat dhe detyrime	4
Tema, 08/11/2009	
<i>Të dhëna zyrtare tregojnë se sasia e kredive që ka marrë biznesi për likuiditet është rreth 37 për qind e gjithë totalit të kredive që ...</i>	
Arben Malaj:Shqiperia eshte ne krize	5
Zeri Popullit, 08/11/2009	
<i>Qeverk nuk pranon asnjë këshillë nga ekspertë venks e të hmj. ...</i>	

BSH: "Bizneset hasin probleme, rritet kredia për likuiditet"

Bizneset po mbijetojnë në treg duke marrë kredi për të paguar punëtorët apo për të blerë lëndën e parë. Kjo pasi sipërmarrja private po përballet me probleme të likuiditetit, të shkaktuar nga kriza ekonomike globale. Ky fakt konstatohet në raportin e fundit të Bankës së Shqipërisë. Të dhënat e institucionit të lartë monetar tregojnë se gjatë pjesës së parë të këtij viti, bankat janë treguar më konservatore në kreditë me pakicë, duke kredi-

tuar bizneset për të mbështetur nevojat e tyre për likuiditet. Kështu kredia për likuiditet shënon një rritje vjetore me 37%, kundrejt rritjes vjetore prej 20% të kredisë për investime. Nga analiza e Bankës së Shqipërisë rezulton se kredia për sektorët e ndërtimit dhe industrisë përpunuese është ulur ndjeshëm. Ndërkohë sektorët e tjerë kanë ruajtur të njëjtin ritëm si më parë. Kjo pasi bankat kanë preferuar të kreditojnë bizneset që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorët e ekonomisë, të lidhur me mallrat e konsumit

bazë. Me vështirësinë në marrjen e një kredie janë përballur edhe qytetarët. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë gjatë periudhës janar –maj 2009 kredia për individët është rritur vetëm me 1.5 miliardë lekë, krahasuar me 12 miliardë lekë që u rrit një vit më parë. Gjithsesi, banka e Shqipërisë është optimiste për ecurinë e kreditimit, gjatë pjesës së mbetur të vitit, pasi sistemi bankar ka sinjalizuar mos shtrëngimin e mëtejshëm të kushteve të kredisë gjatë tremujorit të tretë e në vazhdim.



Plani i gjashtëmujorit, realizohet në masën 88 për qind

Kriza, frenohen të ardhurat doganore

Kriza në ekonominë botërore i kanë dhënë këtë vit efektet tek realizimi i të ardhurave doganore. Për herë të parë gjatë gjithë kësaj periudhe realizimi i të ardhurave plani doganore nuk ka mundur të kapë as 90 për qind të planifikimit. Sipas të dhënave zyrtare të vetë doganave rezultoni që në periudhën janar korrik plani është realizuar vetëm 88 për qind me një mosrealizim që shkon deri në 55 milion euro. Mosreal-

izimi i kësaj periudhe duket se është shkaktuar më së shumti nga karburantet. Shifrat doganore tregojnë se gati gjysma e deficitit doganave iu është shkaktuar nga një mall i vetëm që janë karburantet, të cilët zënë çerekun e të ardhurave. Kështu ndonëse në sasi krahasuar me 6 mujorin e 2008 ku janë zhdoganuar 182 mijë ton karburante kemi rritje në rreth 190 mijë ton në vlerë ndodh e kundërta. Ulja e çmimit ka sjellë, që nga nafta të merren 10.6 miliardë

lekë, në një kohë që një vit më parë ishin mbledhur 12.3 miliardë lekë. Por rënia e të ardhurave të doganave është njëkohësisht edhe pasojë e rënies së volumit të tregtisë me jashtë. Importet e vendit kanë rënë krahasimisht këtë gjashtëmujorë me 5 miliardë lekë, kurse eksportet me 700 milionë. Këto tregues janë sinjale të forta të vështirësive në rritje, me të cilat pritet të ndeshen doganat e për pasojë edhe të ardhurat e buxhetit.



INSTAT: Karburantet, në korrik më të shtrenjta

BRIKENA DEMIRAS

Qytetarët kanë blerë karburante me çmime më të larta gjatë muajit korrik. Instituti i Statistikave bëri të ditur dje indeksin e çmimeve të konsumit, i cili rezultoi 0.7 për qind më i ulët se muaji qershor. Në përgjithësi çmimet e mallrave ishin më të ulëta krahasuar me një muaj më parë, përveç çmimit të naftës dhe benzinës si dhe kostos së telefonatave fikse. Burime nga Instituti i Statistikave njoftuan dje se inflacioni, i njohur si “ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit”, në korrik ishte 2.2 për qind, ndërsa një vit më parë ky ndryshim ishte 3.7 për qind.

Rritja e karburanteve

Edhe pse në tregun ndërkombëtar çmimi i arit të

zi nuk ka pësuar ndonjë ndryshim të madh, efektet e krizës kanë ndikuar në mbajtjen stabël të këtij çmimi. Gjatë muajit korrik tregtarët në pikat e shitjes me pakicë të karburanteve në Shqipëri kanë ndryshuar me rreth 5-6 lekë çmimet në tabela. Kjo është bërë vetëm me qëllim përfitimi, duke shfrytëzuar ardhjen e emigrantëve dhe sezonin e pushimeve. Sipas INSTAT-it, çmimi i naftës në muajin korrik shënoi një rritje prej 1.4 për qind dhe çmimi i benzinës 2.1 për qind. Studimet e bëra nga grupimi më i madh i industrialistëve në vend, Konfindustria, tregojnë se çmimet e karburanteve në Shqipëri janë 25 për qind më të larta nga sa duhej të ishin

në kushtet e funksionimit të një tregu normal. Kjo për shkak edhe të mungesës së një enti rregullator në këtë fushë.

Çmimet e ushqimeve

Sipas INSTAT-it, futja e prodhimit bujqësor vendas në treg dhe ndikimi që kriza ekonomike globale ka në uljen e fuqisë blerëse dhe rrjedhimisht importeve nga shtetet e tjera, ka sjellë edhe një ulje të çmimeve të mallrave të konsumit. Kështu, treguesi i grupit ‘ushqime dhe pije joalkoolike’ shënoi një ulje prej 2.0 për qind. “Brenda këtij grupi ulja më e madhe prej 11.0 për qind vërehet në nëngrupin ‘zarzavate’, përfshirë patatet, ku mund të veçohen ulja e çmimit të specave me

32.6 për qind, domateve me 30.6 për qind, patëllxhanëve me 23.0 për qind, kastravecave me 13.3 për qind. Ndërsa indeksi në nëngrupin fruta shënoi një ulje prej 6.4 për qind, ku mund të veçohen ulja e çmimit të shalqirit me 44.7

për qind, rrushit me 23.4 për qind, pjeprit me 24.7 për qind, dardhëve me 18.4 për qind, kumbullave me 11.0 për qind”, - theksuan burime të Institutit të Statistikave. Të tjera mallra kanë njohur ulje të çmimeve gjatë muajit korrik, si nëngrupet bukë e drithëra me 0.5 për qind, vajra dhe yndyra me 0.3 për qind ulje, qumësht, djathë e vezë me një ulje prej 0.2 për qind.



Biznesi në krizë, 37% e kredive për të paguar pagat dhe detyrime

Të dhëna zyrtare tregojnë se sasia e kredive që ka marrë biznesi për likuiditet është rreth 37 për qind e gjithë totalit të kredive

që janë dhënë nga bankat gjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti. Duket se aktiviteti i biznesit është shndërruar në një

përpjekje të pandalur tashmë për të qëndruar në këmbë përballë efekteve në rritje dhe thellim të krizës ekonomike.

Fitim Zekthi

PAFUQIA E SEKTORIT PRIVAT të ekonomisë shqiptare për të blerë lëndë të parë, paguar punonjësit, paguar detyrimet etj, ka arritur pikën më të mprehtë prej shumë vitesh. Të dhëna zyrtare tregojnë se sasia e kredive që ka marrë biznesi për likuiditet është rreth 37 për qind e gjithë totalit të kredive që janë dhënë nga bankat gjatë gjashtë muajve të parë të këtij viti. Duket se aktiviteti i biznesit është shndërruar në një përpjekje të pandalur tashmë për të qëndruar në këmbë përballë efekteve në rritje dhe thellim të krizës ekonomike. Mungesa e likuiditetit është një problem që është shfaqur më herët se një vit më parë por në pjesën e parë të këtij viti ajo është rënduar tej pritshmërive. Në grafikun që tregon sasinë e kredive për likuiditet ndaj totalit të kredive shihet një kahje e qartë rritëse. Kreditë për investime kanë ardhur duke u rrudhur përballë këtij presioni dhe kjo qartësisht është reflektuar edhe në shumë tregues të tjerë të ekonomisë. Ndonëse ekono-

mia shqiptare ia ka dalë deri më tani të shfaqet elastike përballë krizës ekonomike botërore duke mos rënë në recesion ajo është ngadalësuar mjaft dhe shitjet, prodhimi, vendet e punës etj janë duke rrëshqitur ngadalë por pa u ndalur. Vështirësitë që i janë krijuar ekonomisë shqiptare më së shumti janë të importuara dhe ato nuk kanë lindur nga brenda. Ndërhyrja e qeverisë shqiptare në çastin kur u shfaqën efektet e krizës ekonomike ka qenë pa ndonjë ndryshim të madh me ndërhyrjet që janë kryer më herët kur këto nuk ishin shfaqur ndonëse duhet thënë se rritja e shpenzimeve publike në shkallë të madhe është një masë që rreket të lehtësojë peshën e krizës. Problemi mund të ishte përballur ndoshta më me rezultat nëse shpenzimet publike do të ishin shpërndarë në zëra që veprojnë më mirë në situata të tilla. Sistemi fiskal në vend është përmirësuar në lidhje me legjislacionin duke e lehtësuar biznesin nga një përqindje e caktuar e barrës fiskale dhe kjo ka qenë një

masë që ka ndihmuar në elasticitetin e ekonomisë thonë ekspertët të financave. Banka e Shqipërisë është pa dyshim institucioni më i paqartë në masat e marra për të lehtësuar peshën e krizës. Ajo pasi e rriti tre herë rresht me 0,25 pikë normën e interesit nga viti 2006 në 2008 nga frika për rritje të inflacionit u tregua mjaft e ndrojtur për ta ulur atë kur nevoja për në ekonomi u bë e pazëvendësueshme. Përkundër të gjitha bankave qendrore në botë të cilat i ulën në mënyrë drastike këto norma banka e Shqipërisë vetëm gjashtë muaj pasi kriza u përhap qartë edhe në Shqipëri bëri një ndërhyrje shumë të vogël e cila duket se nuk ka dhënë asnjë efekt. Tashmë kur kriza e likuiditetit në ekonomi është bërë më tepër se shqetësuese ajo po flet për ulje të normës së interesit. Më anë tjetër qeveria është vënë në vështirësi me shpenzimet larta të kryera dhe me mosrealizimin e të ardhurave dhe kjo rrezikon ta çojë më larg peshën e krizës ekonomike.



Crëzimet e shtetshtrëmbësve janë rritur me 15,6% në shtetësi e paqë

Arben Malaj: Shqipëria është në krizë

Qeveria nuk pranon asnjë këshillë nga ekspertë vendas e të huaj. Injorimi tregon papërgjegjshmëri

TIRANË - Ekonomia shqiptare është infektuar nga kriza ekonomike globale dhe pasojat janë mjaft të dukshme. Ish-ministri i Financave, Arben Malaj në një intervistë të dhënë për median thotë se janë të shumtë elementët që tregojnë gjurmët e krizës në ekonominë shqiptare. Sipas tij, muajt e ardhshëm për ekonominë tonë do të jenë edhe më të vështira.

“Ekonomia shqiptare nuk mund t’i shpëtonte krizës. Pasojat janë prezente dhe kjo është shumë e rëndë për ata që ndjejnë direkt. Së pari dhe mbi të gjitha pasojat do të ndjehen nga zhvlerësimi i monedhës kombëtare. Gjendemi përballë një risku, ku kursi i këmbimit rritet në nivele shqetësues. Kjo do të godasë rëndë jo vetëm ata që kanë huamarrjen nga bankat shqiptare në valutë të huaj.

Do të jetë një kosto e rëndë edhe për biznesin, qoftë edhe në rënien e importeve të tyre”.

Ish-ministri i Financave Arben Malaj thotë se, është e nevojshme që qeveria të përgatisë një plan masash për të zbutur pasojat e krizës. Shpenzimet e mëdha buxhetore dhe kostot e larta të borxhit qeveritar nuk ndihmojnë në përballimin e krizës, pasi ato janë një faturë që shqiptarët do ta paguajnë shtrënjtë në muajt në vazhdim.

Malaj thekson se, “ka mundësi transparence të të dhënave të buxhetit për të ardhurat dhe shpenzimet. Vitet e fundit, ne dimë që është punuar me një nivel të lartë të deficitit buxhetor. Tashmë, qeveria paguan kosto më të larta për paratë që financon ne ekonomi, pasi është shumë e lartë kostoja e borxhit të marrë nga qeveria. Të gjitha këto borxhe në një kohë

të dytë do të jenë taksa për tu paguar nga shqiptarët. Duket se qeveria shqiptare, akoma nuk ka transparencën e nevojshme me publikun për të parë përmasat e shqetësimit që ka sjellë kriza në vend. Qeveria nuk pranon asnjë këshillë apo konstatim që bëjnë ekspertë vendas dhe të huaj. Injorimi i krizës nga ana e qeverisë tregon papërgjegjshmëri”, u shpreh Malaj.

Ish-ministri i Financave kërkon nga qeveria të pranojë ekzistencën e krizës globale në ekonominë shqiptare dhe të marrë masa për përballimin e saj. “Të mos e shikosh krizën kur ka rënë aktiviteti ekonomik në vend do të thotë që ta çosh ekonominë e vendit në një situatë më të vështirë në muajt e ardhshëm”, e mbyll prononcimin e tij ish-ministri i Financave Arben Malaj.

